



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Ministria e Shëndetësisë
INSTITUTI KOMBËTAR I SHËNDETËSISË PUBLIKE

Analizë e situatës epidemiologjike me COVID-19

25 dhjetor 2024

SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE ME COVID-19

Situata epidemiologjike globale

Rastet globale: Sipas të dhënave të fundit të OBSH që nga 31 dhjetor 2019 deri 8 dhjetor 2024, janë raportuar gjithsej 777,026,543 raste të COVID-19 dhe 7,078,481 raste të vdekjes dhe janë administruar 13.64 miliard doza të vaksinës kundër COVID-19.

Situata epidemiologjike në Kosovë nga fillimi i pandemisë


Nga data 08.02.2020 deri më 24.12.2024, u realizuan gjithsej 2,004,053 teste të rasteve të dyshimta në virusin SARS-CoV-2. Testimi është bërë me qëllim që të gjurmohen të gjitha kontaktet e rasteve të konfirmuara të cilat janë gjetur në mënyrë aktive nga ekipet e IKSHPK-së.

Me SARS-CoV-2, janë diagnostikuar gjithsej 276,173 raste ose 13.78% e mostrave të testuara. Deri më 24.12.2024, janë shëruar 272,938 raste ose 98.82% e të infektuarve, ndërsa aktualisht janë dy raste aktiv. Deri më tani, janë regjistruar gjithsej 3,233 raste të vdekjeve me një shkallë të letalitetit prej 1.17%.

Situata epidemiologjike në Kosovë në dy javët e fundit


Në dy javët e fundit (11.12.2024 – 24.12.2024) janë raportuar dy raste pozitive dhe asnjë rast i vdekjes me COVID-19. Sipas grup-moshave: grup-mosha: 0-9 vjec (1 rast) dhe 50-59 vjeç (1 rast).

Grafikoni 1. Totali i rasteve të testuara, të konfirmuara, të shëruara dhe vdekjet nga COVID-19 në 14 ditët e fundit




Gjatë dy javëve të fundit prej rasteve të konfirmuara me COVID-19, sipas komunave rezultojnë se 1 rast i përket komunës së Prishtinës dhe një rast komunës së Ferizajit.

Grafikoni 2. Totali i rasteve, Incidenca dhe vdekjet/100,000 banorë në 14 ditët e fundit




Nga rastet e raportuara gjatë kësaj periudhe 2 javore, sipas grup-moshës: grup-mosha: 0-9 vjeç (1 rast) dhe 50-59 vjeç (1 rast). Sipas incidencës specifike për grup-moshë, 0-9 vjeç me 0.37/100,000 banorë dhe 50-59 vjeç me 0.49/100,000 banorë.

Grafikoni 3. Rastet dhe Incidenca specifike për grup-moshë në 14 ditët e fundit



Gjatë dy javëve të fundit prej rasteve të konfirmuara me COVID-19, sipas gjinisë rezulton se Të dy gjinitë prezentohen me nga 1 rast të raportuar.

Grafikoni 4. Numri i rasteve me COVID-19 sipas gjinisë në 14 ditët e fundit




Gjatë dy javëve të fundit, sipas profesionit, rastet e konfirmuara të shprehura në përqindje janë si vijon:

- Profesionistët shëndetësor 0.00%
- Mësimdhënës 0.00%
- Policia 0.00%,
- Gardianët 0.00%
- Të burgosur 0.00%
- Zjarrfikës 0.00%
- FSK 0.00%,
- Kurse 100.0% janë raste të konfirmuara brenda familjeve dhe institucioneve publike dhe private.

Nga punëtorët shëndetësor janë:

- Mjek 0.00%
- Infermier 0.00%
- Farmacist 0.00% dhe
- Fizioterapeut 0.00%.

Grafikoni 5. Pozitiviteti i rasteve (%) dhe numri i rasteve aktive në 14 ditët e fundit



Gjatë dy javëve të fundit janë testuar gjithsej 313 raste të dyshimta me COVID-19 me një pozitivitet mesatar prej 0.38%. Sa i përket rasteve aktive në 14 ditët e fundit, momentalisht ka 2 raste aktive.

Modeli epidemiologjik i projeksionit të numrit të rasteve të pritshme ditore dhe numrit efektiv të riprodhimit deri me 24 dhjetor 2024, sipas metodës R

Duke shfrytëzuar gjuhën programuese R [R version 4.3.0 (2023-04-21 ucrt)] është bërë projeksioni i situatës epidemiologjike me COVID-19 deri me 18 nëntor 2024, i cili paraqitet me ndryshime nga projeksionet e muajve të fundit. Projeksionet janë bërë përmes pakove të R dhe algoritmeve matematikor, të bazuar në parametra standard global, duke shfrytëzuar të dhënat e rasteve me COVID-19 nga data 09 shtator 2024. Pakoja e modelimit të sistemit R përdor një qasje joparametrike për të rindërtuar rastet sipas datës së infektimit në raport me datën e raportimit të rasteve. Kjo arrihet përmes një modeli gjenerues ose një llogaritje joparametrike për të vlerësuar infeksionet latente dhe më pas i merr për bazë këto infeksione dhe së bashku me rastet e raportuara krijon një model epidemiologjik parashikimi (forecasting). Parashikimi i numrit të riprodhimit bëhet sipas metodologjisë të lartëcekur, të adaptuar nga Stan dhe Abbot, duke shfrytëzuar rastet e raportuara sipas datave, kohën e vonës së raportimit, kohën e gjenerimit si dhe parametra tjerë ndërkombëtar të COVID-19.

Tabela 1 Vlerësimet më të fundit të numrit të rasteve të konfirmuara sipas datës së raportimit, ndryshimi i pritshëm në rastet e konfirmuara ditore, numri efektiv i riprodhimit, shkalla e rritjes dhe koha e dyfishimit

Parametri i vlerësuar	Vlerësimi
Rastet e reja të konfirmuara sipas datës së raportimit	1 (0 – 11)
Ndryshimi i pritshëm në rastet e konfirmuara ditore	Stabil dhe në rënie
Numri Efektiv i Riprodhimit.	0.47 (0.037 – 1.51)
Shkalla e rritjes ditore	-0.16 (-0.35 – 0.13)
Koha e dyfishimit/përgjysmimit	-4.3 (5.2 – -2.1)




Figura 1 A) Rastet e konfirmuara sipas datës së raportimit (grafiku me bar-charts) dhe datës së parashikuar të raportimit të tyre; B) Rastet e konfirmuara sipas datës së infektimit (grafiku me bar-charts) dhe datës së tyre të parashikuar të infektimit; dhe C) Vlerësimi i Numrit Efektiv të Riprodhimit që ndryshon sipas kohës (shiriti më i lehtë = 20% interval i besueshëm; shiriti më i errët = intervali 50% i besueshëm, shiriti më i errët = intervali 90% i besueshëm). Këto duhet të konsiderohen vetëm

Në Departamentin e Mikrobiologjisë, IKSHPK, Prishtinë, janë sekuencuar me sukses dhe analizuar gjatë javës së kaluar në total 83 mostra me SARS-CoV-2 të mbledhura nga rastet pozitive në SARS CoV-2 në Kosovë nga periudha 10 korrik – 09 gusht 2024, përkatësisht nga java njëzet e tetë (28)- java tridhjetë e dy (32) e vitit 2024.

Klasifikimi i varianteve shërben si një mjet i rëndësishëm komunikimi, për të paralajmëruar vendet për shfaqjen e varianteve të SARS-CoV-2 me veçori shqetësuese, e që mund të ndikojnë në situatën epidemiologjike. Edhe në laboratorin tone, përcjellja e situatës epidemiologjike me COVID-19 është orientuar drejt sekuencionimit dhe hulumtimit të varianteve eventuale të reja në qarkullim.

Përqindja e pozitivitetit të SARS-COV-2 në nivel rajonal vazhdon të bjerë ngadalë, por ka ndryshime midis vendeve dhe zonave. Grup moshat më të vjetra vazhdojnë të përbëjnë përqindjen më të lartë të rasteve. Aktiviteti i gripit dhe RSV mbetet i ulët.

SARS-CoV-2 ishte 10% krahasuar me 10% në javën e kaluar. Norma mesatare e pozitivitetit për 18 vende dhe zona ishte 8% (varg: 0%-24%). Në të gjithë rajonin, përqindja e të gjithë mostrave nga pacientët që paraqiten në qendrat e SARI-s sentinel që rezultuan pozitivë për SARS-CoV-2 ishte 13% krahasuar me 14% në javën e kaluar.

Midis javëve 48/2024 dhe 49/2024, 10 vende dhe zona raportuan informacion mjaft të plotë për të lejuar llogaritjen e frekuencës relative të varianteve specifike. Midis këtyre vendeve dhe zonave, përqindja mesatare (gama) e të gjitha izolimeve të sekuencave të virusit të zbuluara, që janë një variant aktual ose i mëparshëm shqetësimi ose variant interesi, ishte:

- PK.3: 41% (18%-79% nga 10 vende dhe zona).
- BA.2.86: 14% (6=0%-82% nga 7 vende dhe zona). Shënim: Izolat JN.1 përfshihen në BA.2.86.
- Variantet më të zakonshme SARS-CoV-2 në GISAID për Rajonin Evropian në tetor deri më tani ishin: KP.3.1.1 (28%); XEC (50%); KP.3.1 (2%); JN.1 (5%); JN.1.11 (4%); dhe JN.1 (5%) (n=195).

Në Kosovë varianti i SARS-CoV-2 Omicron BA.2.86 dhe subvariantet e tij, përfshirë KP.3, dominojnë në mesin e mostrave të testuara pozitive në virusin SARS CoV-2, në periudhën një-mujore nga 10 Korrik deri 9 Gusht 2024.

- ***53% për Variantin KP.3 (44 detektime)***
- ***47% për Variantin BA.2.86 (39 detektime).***

Rrjedhimisht, prania e nën-linjave të variantit të Omicronit të SARS-CoV-2 në Kosovë është në përputhje të përafërt me epidemiologjinë virologjike të SARS-CoV-2 në vendet tjera Europiane, përkatësisht me dominim të variantit KP.3.

Për më shumë detaje, gjeni të dhënat në tabelën e bashkangjitur:

Variantet e SARS-CoV-2 në Kosovë, korrik-gusht, 2024

- Faqe 8 prej 9

REKOMANDIME

Varianti SARS-CoV-2 BA.2.86 dhe nënvariantet e tij, duke përfshirë KP.3, vazhdojnë të dominojnë në vendet e BE/ZEE.

Gjendja post-COVID-19 (PCC) vazhdon të përbëjë një barrë të konsiderueshme për sistemet shëndetësore. Është sfiduese të vlerësohet incidenca e PCC me saktësi të lartë, por të dhënat sugjerojnë se afërsisht 6% e rasteve simptomatike me SARS-CoV-2 rezultuan në simptoma të PCC. Ndërsa COVID-19 i rëndë është një faktor rreziku i rëndësishëm për PCC, mbi 90% e rasteve me PCC zhvillohen pas COVID-19 mesatar.

Vaksinimi është masa më efektive për t'u mbrojtur kundër formave më të rënda të COVID-19 dhe gripit sezonal. Meqenëse efekti mbrojtës zvogëlohet me kalimin e kohës, promovimi i vaksinimit kundër sëmundjeve virale të frymëmarrjes sipas rekomandimeve kombëtare përpara fillimit të sezonit të dimrit mbetet i rëndësishëm për të gjitha vendet e BE/ZEE, veçanërisht për të mbrojtur individët me rrezik më të lartë të sëmundjeve të rënda.

Në kuadër të mbikëqyrjes epidemiologjike të SARS-CoV-2 në Republikën e Kosovës dhe rekomandimeve të fundit të CDC dhe ECDC, rekomandojmë që:

1. Të bëhet testimi i rasteve të dyshimta sipas definicionit të rastit dhe sipas rekomandimeve të mjekut/klinikistit, si dhe rastet pozitive të raportohen në IKShPK;
2. Rastet që rezultojnë pozitiv në SARS-CoV-2 rekomandohet që të izolojnë për 5 ditë, kurse kthimi në aktivitetet normale pune të bëhet sipas rekomandimit të mjekut/klinikistit;
3. Personat e kontaktit me personin e sëmurë të mos izolojnë por të përdorin masat për të parandaluar përhapjen e infeksionit, duke përfshirë përcjelljen e vazhdueshme të simptomave dhe distancimin larg të tjerëve, sidomos ndaj personave me sëmundje kronike dhe atyre të moshuar.
4. Rekomandojmë vaksinimin e popullatës bazuar në Planin e Imunizimit, me theks të veçantë për grupet e rrezikut (personat me sëmundje kronike jongjithëse, personat ≥65 vjeç etj). Megjithatë personat e vaksinuar ndonjëherë infektohen me virusin që shkakton COVID-19, rivaksinimi me vaksinat kundër COVID-19 ul ndjeshëm rrezikun për format e rënda të sëmundjes, shtrimet në spital dhe rastet me fatalitet nga COVID-19;
5. Rastet ambulantore dhe të hospitalizuara në ShSKUK, rekomandohet të analizohen nga ana e konziliumit të mjekëve përmes auditeve, në bashkërendim me kapacitetet e planifikuara të ShSKUK e që paraqet një indikatorë për zbatim rigoroz dhe respektim të masave në fuqi për të parandaluar variantet e reja të SARS-CoV-2.
6. Të respektohet bartja e maskave dhe mjeteve tjera mbrojtëse si dhe reduktimi i vizitave të familjarëve në institucionet shëndetësore që merren me trajtimin e rasteve me COVID-19 dhe infeksione tjera me patogjenë respiratorë;
7. Të gjitha institucionet shëndetësore sipas Ligjit Nr. 08/L-200 për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve Ngjithëse, të raportojnë për çdo rast të vdekjes nga sëmundjet ngjithëse (përfshirë edhe COVID-19) duke qenë me diagnozë të qartë;
8. Trajtimi i pacientëve me COVID-19 të bëhet sipas udhërrëfyesit klinik për menaxhimin dhe trajtimin e këtyre rasteve;
9. Për të rejat dhe masat parandaluese rreth COVID-19 të informohet popullata në mënyrë kontinuele.